



Datë: 04.08.2025
Numër Protokolli: 5479/2025

A.nr.950/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari, kryetare, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj-Demi, anëtarë, me Atdhe Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.950/2025, të datës 23.05.2025, të parashtruar nga ankuesi Z.M, kundër organit të punësimit/Komuna e Graçanicës, në çështjen juridike “*ndërprerje e marrëdhënies së punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1 nën, paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafin 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 04.08.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.950/2025, e datës 23.05.2025 e parashtruar nga ankuesi Z.M.

II. Anulohet Vendimi me numër protokolli 1017/21 i datës 16.04.2025 i Menaxheres së Personelit në Komunën e Graçanicës, Vendimi me numër protokolli 1479/25 i datës 18.04.2025 si dhe Vendimi me numër protokolli 1652/25 i datës 29.04.2025, i Komisionit Disiplinor të Komunës së Graçanicës

III. Mbetët në fuqi Vendimi me numër protokolli 6882/24 i datës 30.12.2024, i Menaxheres së Personelit në Komunën e Graçanicës

IV. Obligohet Kryetarja e Komunës dhe Udhëheqësja e Personelit në Komunën e Graçanicës, që brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi të bëjë zbatimin e tij sipas pikës II dhe III, dhe të beje kompensimin e pagës prej 50% për ankuesin Z.M në mënyrë retroaktive prej datës 16.04.2025 deri në ditën e zbatimit të këtij vendim.

V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi, Z.M (tutje referuar vetëm: *ankuesi*), më datë 23.05.2025, ka parashtruar ankesë me numër protokolli 3414/2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër protokolli 1652/25, të datës 29.04.2025, të Komisionit Disiplinor të Komunës së Graçanicës, me të cilin akt të njëjtit i është shqiptuar masa disiplinore “*largim nga shërbimi civil*”.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (tutje referuar vetëm: *Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datës 10.06.2025 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Graçanicës, ndërsa, kjo e fundit më datë 12.06.2025 ka përcjell përgjigjen në ankesë.

Kryetari i Këshillit, pas pranimit të kërkesës së Kryetares së Kolegjit për Shqyrtimin dhe Vendosjes së Ankesave, me Vendimin me numër VK/2025 dhe numër të protokollit 4531/2025 të datës 07.07.2025, ka shtyrë afatin për vendosje të ankesës së parashtruar nga ankuesi edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për shqyrtimin e kësaj lënde ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 3414/2025 të datës 23.05.2025, të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës; Vendimin me numër protokolli 1480/25 të datës 18.04.2025; Vendimin me numër protokolli 6882/24 të datës 30.12.2024; Vendimin me numër protokolli 1417/21 të datës 16.04.2025; Vendimin me numër protokolli 1479/25 të datës 18.04.2025; Vendimin me numër protokolli 1652/25 të datës 29.04.2025; Akt emërimit të datës 12.06.2012; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 10.06.2025; Përgjigjen në ankesë të datës 12.06.2025; Aktvendimin PPPKR.nr.283/24 të datës 11.03.2025; Raportin e policisë së datës 27.12.2024; Fotografimet; Kërkesën me numër protokolli 1221/25 të datës 03.04.2025; Thirrjen me numër protokolli 1842/25 të datës 18.04.2025; Thirrjen me numër protokolli 1481/25 të datës 18.04.2025; Kërkesën për iniciimin e procedurës disiplinore me numër protokolli 1488/25 të datës 16.04.2025; Procesverbalin me numër protokolli 1478/25 të datës 18.04.2025; Procesverbalin me numër protokolli 1546/25 të datës 22.04.2025; Procesverbalin me numër protokolli 1651/25 të datës 29.04.2025; Vendimin për themelimin e Komisionit Disiplinor, Akt emërimet dhe kualifikimet arsimore të anëtarëve të Komisionit Disiplinor; Formularët e vlerësimit të rezultateve të punës; E-mailin e datës 29.07.2025 të Prokurorisë së Shtetit.

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka gjetur se rastin e ankuesit, është **e bazuar, sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se ankuesi sipas Akt Emërimit të datës 12.06.2012, mban pozitën e punës Gjeodet në Komunën e Graçanicës

Me tej sipas shkresave të lëndës rrjedhë se, Menaxherja e Personelit e Komunës së Graçanicës me Vendimin me numër protokolli 6882/24 të datës 30.12.2024, ka pezulluar ankuesin nga marrëdhënia e punës me 50% të pagës, për shkak të arrestimit dhe paraburgimit të tij.

Tutje, Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti për Krime të Rënda, me datë 11.03.2025 ka nxjerrë Aktgjykimin me shifër PPPKR.nr.238/24, mbi të cilin aktgjykim rezulton se Gjykata ka aprovuar kërkesën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të Rënda, PP.I.nr.204K/24, për ndërprerjen e paraburgimit të ankuesit, i cili gjendej në paraburgim nga data 26.12.2024, për shkak të dyshimit të bazuar se në bashkëkryerje ka kryer veprat penale Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 414 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 dhe nenin 31 të KPRK-së dhe veprën penale Marrja e ryshfetit nga neni 421 paragrafi 3 lidhur me paragrafin 2 dhe nenin 31 të KPRK-së, rrjedhimisht lirimi është realizuar mbi arsyetimin se Prokuroria ka marrë në pyetje ankuesin, i cili është shpallur dëshmitar bashkëpunues dhe ka arritur marrëveshje për pranimin e fajësisë në pajtim me nenin 231 të KPRK-së.

Ankuesi, me datë 03.04.2025, i është drejtuar me kërkesën me numër protokolli 1221/25 Komunës së Graçanicës, përmes së cilës ka kërkuar heqjen e masës së pezullimit, duke bashkangjitur me këtë rast edhe Aktgjykimin me shifër PPPKR.nr.238/24 të datës 11.03.2025, ndërsa Menaxherja e Personelit me datës 16.04.2025 ka nxjerrë Vendimin me numër protokolli 1017/21, përmes të cili ka ndërprerë pezullimin e marrëdhënies së punës së ankuesit.

Ndërsa, Drejtori i Drejtorisë së Kadastrit të Komunës së Graçanicës, në cilësi të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të ankuesit, me datë 16.04.2025, ka parashtruar kërkesën për iniciimin e procedurës disiplinore me numër protokolli 1448/25, tek Komisioni Disiplinor, me arsyetimin se sipas Aktgjykimit të lartë theksuar i njëjti është liruar nga paraburgimi dhe se ka pranuar pranimin e fajësisë për dhe ka marrë statutin e dëshmitarit bashkëpunues për veprat penale për të cilat akuzohet ankuesi lidhen drejtpërdrejtë me obligimet dhe detyrat e kryera nga i njëjti, gjegjësisht mbi pretendimet për shkelje të rënda disiplinore, sipas nenit 56 paragrafi 4, nën paragrafi 4.9 dhe 4.20 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik.

Komisioni Disiplinor i Komunës së Graçanicës me Vendimin me numër protokolli 1479/25 të datës 18.04.2025, ka aprovuar kërkesën për iniciimin e procedurës disiplinore, ndërsa me Vendimin me numër protokolli 1480/25 të po kësaj date ka pezulluar ankuesin përkohësisht nga puna deri në marrjen e vendimit përfundimtar, gjegjësisht Vendimit me numër protokolli 1652/25, të datës 29.04.2025, përmes të cilit akt ankuesin e ka shpallur përgjegjës për shkelje të rënda disiplinore të përcaktuar nga neni 56, paragrafi 4, nën paragrafi 4.9 dhe 4.20 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, dhe si shkeljes së kodit të Etikës të Komunës së Graçanicës, duke i shqiptuar masën disiplinore “largim nga shërbimi civil”, sipas nenit 52 paragrafit 2 nën paragrafit 2.7, të këtij ligji.

Ankuesi në ankesën e parashtruar për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se Vendimi me numër protokolli 1652/25 i datës 29.04.2025, i Komisionit Disiplinor të Komunës së Graçanicës, është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe në kundërshtim me ligjin material, duke theksuar ndër të tjera se vendimi i kundërshtuar me ankesë është nxjerrë duke u bazuar në atë se i njëjti ka bërë marrëveshje mbi pranimin e fajësisë me Prokurorin e Shtetit, por se kjo marrëveshje nuk paraqet vendim përfundimtar gjyqësor, dhe se çështja e tij është ende në hetime nga organet përkatëse, mirëpo nuk ka aktakuzë të ngritur ndaj tij dhe ende nuk ka gjykim-seancë gjyqësore mbi fajësinë e tij. Andaj, ankuesi kërkon aprovimin e ankesës, anulimin e kërkesës për iniciimin e procedurës disiplinore dhe vendimit kontestues, ndërsa po ashtu kërkon të mbetet në fuqi Vendimi me numër protokolli 6882/24 të datës 30.12.2024, për pezullimin nga marrëdhënia e punës me 50% të pagës, dhe me realizim e pagës në mënyrë retroaktive.

Kolegji i Këshillit, lidhur me çështjen e pezullimit të marrëdhënies së punës, ju referuar dispozitave të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, gjegjësisht:

- Neni 68 paragrafi 1, përcakton se: *“1. Pezullimi është ndërprerja e përkohshme e marrëdhënies së punës në shërbimin civil që bëhet: 1.1. sipas detyrës zyrtare; 1.2. me kërkesë të nëpunëses/it civil”*.
- Neni 69 paragrafi 1 dhe 2, ku përcaktohet se: *“1. Nëpunësja/i civil pezullohet sipas detyrës zyrtare, në rastet si në vijim: 1.1. në rastin e procedurës disiplinore sipas paragrafit 4. të nenit 59 të këtij ligji; 1.2. kur emërohet në një nga funksionet e përcaktuara në paragrafin 1. të nenit 3 të këtij ligji, për periudhën përkatëse të emërimit; 1.3. transferohet, për nevoja të institucionit, në një organizatë ndërkombëtare apo në një institucion ndërkombëtar, për periudhën përkatëse; 1.4. kur gjykata pezullon nëpunësen/in civil që është person zyrtar nga ushtrimi i detyrës, për kushtet dhe shkaqet të parapara në legjislacionin përkatës në fuqi; 1.5. ndaj nëpunëses/it civil është iniciuar procedurë penale për kryerje të veprës penale gjatë ushtrimit të funksioneve të saj/tij; 1.6. nëpunësja/i civil, mbahet në arrest në pritje të vendimit të formës së prerë; 1.7. deklarohet e/i zhdukur me vendim të formës së prerë të gjykatës, deri në shfaqjen e personit apo deklarimit të vdekjes me vendim të formës së prerë të gjykatës; 1.8. regjistrohet apo zgjidhet, sipas ligjit, si kandidate për zgjedhjet qendrore e lokale, sipas nenit 25 të këtij ligji; 1.9. ndodhet në gjendje konflikti të vazhdueshëm interesi, sipas ligjit të veçantë, deri në transferimin e saj/tij në një pozitë tjetër, në përputhje me nenin 64 të këtij ligji; 1.10. gjatë ndjekjes së ndonjë programi arsimimi apo trajnimi më të gjatë se tridhjetë (30) ditë, për nevojat e institucionit, për periudhën që ndjek këtë program me shpëputje nga puna; 1.11. në*

raste të tjera, të parashikuara shprehimisht me ligj. 2. Përveç kur përcaktohet ndryshe me këtë ligj, konstatimi i shkakut të pezullimit bëhet nga: 2.1. NjMBNj e institucionit, ku nëpunësja/i ushtron detyrën”.

- Neni 71 paragrafi 8, ku përcaktohet se: 8. Nëpunësja/i civil gjatë periudhës së pezullimit nuk përfiton pagë, me përjashtim në rastin e përcaktuar në paragrafin 1., nën-paragrafët 1.4., 1.5., 1.6. dhe 1.7. të nenit 69 të këtij ligji, nëpunësja/i civile përfiton pesëdhjetë për qind (50 %) të pagës së plotë, duke përjashtuar çdo lloj shtesë në pagë, deri në fund të periudhës së pezullimit.

Andaj, referuar kuadrit ligjor si më lartë si dhe bazuar në njoftimin me e-mail të Prokurorisë së Shtetit-Departamenti për Krime të Rënda, konstatohet se ndaj ankuesit janë duke u zhvilluar hetime në çështjen penale me numër PP.I.nr.204/24 dhe se aktualisht nuk ndonjë aktakuzë të ngritur ndaj tij si dhe bazuar në Aktgjykimin me shifër PPPKR.nr.238/24 e datës 11.03.2025 të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Krime të Rënda, me datë 11.03.2025, mbi të cilin aktgjykim rezulton se Gjykata ka aprovuar kërkesën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të Rënda, PP.I.nr.204K/24, për ndërprerjen e paraburgimit të ankuesit për shkak se i njëjti është shpallur dëshmitar bashkëpunues dhe ka arritur marrëveshje për pranimin e fajësisë sipas Nenit 231 të KPRK-së, Kolegji i Këshillit, konstaton se në rastin konkret nuk kanë përfunduar hetimet lidhur me çështjen përkatëse për të cilën hetohet ankuesi dhe se nuk ka aktgjykim të formës së prerë mbi të cilin konstatohet se fajësia apo pafajësia e tij, nga rrjedhë se në këtë rast nuk janë plotësuar kushtet ligjore për ndërprerjen e pezullimit të marrëdhënies së punës së ankuesit, ashtu siç është vendosur përmes Vendimit me numër protokolli 1017/21 të datës 16.04.2025 kur është aprovuar kërkesa e ankuesit e datës 03.04.2025 dhe as inicimit të procedurës disiplinore ndaj tij, rrjedhimisht shqiptimit të masës disiplinore sipas Vendimit me numër protokolli 1652/25 të datës 29.04.2025, të Komisionit Disiplinor të organit përkatës të punësimit.

Theksuar si më sipër, Kolegji i Këshillit, konstaton se Vendimi me numër protokolli 1017/21 i datës 16.04.2025 i Menaxheres së Personelit në Komunën e Graçanicës, Vendimi me numër protokolli 1479/25 i datës 18.04.2025 si dhe Vendimi me numër protokolli 1652/25 të datës 29.04.2025, të Komisionit Disiplinor në Komunën e Graçanicës, janë në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, përkatësisht me nenin 69 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të, si dhe nenin 5 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Rregullores Nr.28/2024 për Pezullimin nga Marrëdhënia e Punës, ashtu që të njëjtat akte konsiderohen të paligjshme në kuptim të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, për rrjedhojë të njëjtat janë anuluar si në dispozitiv të këtij vendimi, ndërsa është lënë në fuqi Vendimi me numër protokolli 6882/24 i datës 30.12.2024, i Menaxheres së Personelit në Komunën e Graçanicës, për pezullimin e marrëdhënies së punës së ankuesit, me obligimin ligjor që kjo e fundit duke u bazuar në dispozitat e nenit 71 paragrafit 8 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, ta kompensojë ankuesin në mënyrë retroaktive nga data 16.04.2025 deri në ditën e zbatimit të këtij vendimi.

Bazuar si më sipër, e në mbështetje të nenit 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.950/2025

Atdhe GASHI

Procesmbajtës

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit Z.M;
- Kryetares së Komunës dhe Menaxheres së Personelit në Komunën e Graçanicës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.